

1. Informacionin ne lidhje me kerkesen dhe llojin e Lejes Mjedisore qe duhet te pajiset ky aktivitet

Referuar Ligjit Nr.10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndyshuar me ligjin Nr.60/2014, shtojca 1,

- Industria Minerare

3.7. Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur dhe nga guroret

Referuar procesit teknologjik te prodhimit fishekzjarreve, kjo veprimtari perfshihet ne pikat 3.7. te Shtojces 1 te ligjit per lejet e mjedisit, i ndyshuar.

Kapaciteti kufi: Referuar ligjit per kete lloj veprimtarie nuk ka kapacitet kufi por aplikohet Leje Mjedisore e Tipit B per te gjitha keto lloj instalimesh.

Sidoqofte, disa nga te dhenat kryesore te shfrytezimit te kesaj Karriere te gurit geleqeror jane ato te miratuara ne lejen e shfrytezimit: Siperfaqja 0.24 km², dhe ka nje kapacitet prej 20.000 m³/vit e barabarte me 60.000 ton/vit.

Per sa me siper trajtuam, Leja Mjedisore qe duhet pajiset kjo veprimtari duhet te jete LEJE MJEDISORE – Tipi "B".

2. Te dhena te ekstraktit te leshuar nga QKB

Sipas Ekstraktit te regjistrimit tregtar te leshuar nga QKB, po japim me poshte te dhenat e subjektit:

NUIS:	J64104078V
Data e Rregjistrimit:	06.08.1996
Emri i Subjektit:	FAVINA Sh.p.k.
Selia e shoqerise:	Lagjia 7, rruga Ismail Qemali, Nr.13, Korçe
Administrator:	Viktor Qylafi
Ortaket:	Viktor Qylafi, zoteron 50% te aksioneve Adnan Qylafi, zoteron 50% te aksioneve
Objekti i aktivitetit:	Nder te tjera edhe, veprimtari me lende plasese per perdorim civil. Shitje me shimice dhe me pakice materiale ndertimi, inerte, betone etj..

Bashkelidhur do te gjeni nje kopje origjinale te Ekstraktit te Regjistrimit Tregtar te Leshuar nga QKB.

3. Adresa e Vendndodhjes se instalimit

Fshati Zvezde, Njesia Administrative Pojan, Korçe.

4. Pershkrim i veprimtarise qe parashikohet te zhvillohet ne instalim

Pershkrim i pergjithshem

Objekti i gelqeroreve per materjal ndertimi Zvezde ndodhet ne perendim te rruges automobilistike Korce-Liqenas ne Lindje te fshatit Zvezde rreth 700 m larg rruges qe shkon ne Zvezde.

Rajoni ne fjale ne pjesen veriore e ne qender te tij ka kreshten malore te vargut malor te Malit te Thate te perfaqesuar nga maja e Ivanit 1786m. Ne pjesen jug-perendimore cepin e fushes se Korces dhe terenin kodrinor te kodrinave ne jug te fshatit Burimas qe me kodrinen me relief te rumbullaket Bregu i Qershise ne kuote 954.4 m qe zgjatet drejt lindjes deri e Mancurisht.

Ne afersi te objektit nuk kaloj ne linja elektrike te tensionit larte apo te ulet. Objekti ben pjese ne planshetin e shkalles 1:25 000 me nomenklature K-34-114-D-d (Zemblaku) dhe kufizohet nga koordinata e me poshteme (shih tabelen Nr.1). Siperfaqja e zones te kerkuar per shfrytezim eshte 0.237 km².

Tabela Nr. 1 Koordinatat e pikave qe kufizoj ne zonen e shfrytezimit

PIKA	Y	X
1	4490000	4511400
2	4490500	4511175
3	4490600	4510637
4	4490350	4510525

Objekti i gelqeroreve ndodhet ne lindje te qytetit te Korçes. Ne pjesen perendimore te objektit ndodhet fshati Zvezde me nje largesi rreth 1 km. Objekti ka nje gjatesi prej 942 m dhe gjeresi 411m. Nga pikpamja gjeografike terreni ku shtrihet objekti qe kerkohet per shfrytezim, duke gene se ben pjese ne zonen kodrinore malore te lindje-juge lindjes se Vendit tone, eshte terren kodrinoro-malor, i nderthurur ndermjet pjeses fushore-kodrinore dhe asaj malore, lartesite e te cilave jane mbi 800m mbi nivelin e detit. Relievi i zones ka nje pjeresi rreth 30°,

Vete terreni ku kerkohet leja minerare eshte i aksidentuar dhe mjaft i shpelare nga erozioni dhe ne pjesen e poshteme te tij ka depozitime te konsiderueshme cope zore te shkembinjve gelqerore, qe ndodhen ne pjeset e siperme te tij,



Menyra e Shfrytezimit

Duke marrë në konsideratë elemente të tjera si : topografi në, sasi në e rezervave, karakteristikat gjeomekanike të shkembnjëve, elementet e shtruarjes dhe zbulimin pothuajse të paperfillshëm, është parashikuar shfrytezimi me karriere të rezervave të llogaritura të objektit dhe me pashtje janë paraqitur llogaritjet përkatëse.

Kryerja e punimeve të shfrytezimit me qiell të hapur, gjithashtu, favorizohet nga:

- Rënia e formacioneve, që ndërtojnë pakon produktive në drejtim të njëjtit me terrenin në pjesën ku parashikohet të zhvillohet aktiviteti mineral me një kënd mesatar 32° .
- Fortësia e pershtatshme e mbulesave deluvionale, të cilat mund të gërmohen me lehtësi me mjete të mekanizuar pa patur nevojën e përdorimit të Lendeve Plasuese
- Hidrografia e zonës, në përgjithësi dhe e pjesës së kërkuar për leje minerare në veçanti, e cila nuk krijon probleme për shfrytezimin e vendburimit.
- Hidrologjia, burimet e ujërave etj, të cilat nuk janë të pranishme në zonën e shfrytezimit dhe për rreth saj.
- Mungesa e zbulimit, në saj të të cilit nuk ka nevojë për sipërfaqe të depozitimit të përhershëm ose të perkohshëm të sterileve.

Minerali që do të shfrytezohet përfaqësohet nga gëlqerori i cili mund të përdoret për prodhimin inertesh të ndryshme dhe gëlqere. Eksperiencat e shfrytezimit disa dhjetra vjeçar në këtë rajon ka treguar me se miri mundësinë e përdorimit të këtij guri gëlqeror në fushat e mesipërme. Pavarësisht nga sa më sipër, për të gjykuar mbi fushën e përdorimit të materialit të këtij objekti u morën prova përkatëse dhe u kryen analizat kimike dhe fiziko-mekanike.

Analizat kimike u kryen me qëllim të përcaktimit të mundësisë së përdorimit për prodhimin gëlqereje, ndërsa ato fiziko mekanike për prodhimin e inerteve karbonatike si dhe rërës, granilit dhe çakullit

Përberja kimike e gëlqeroreve të analizuar në këto vendburime është si në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr 3 Treguesit cilësorë të gëlqerorit të objektit

CaO	Fe ₂ O ₃	MgO	Al ₂ O ₃	Na ₂ O	K ₂ O	SiO ₂	Hk
53.4 - 55.2%	0.12- 0.25%	0.72-1.4%	0.92-1.4%	0.25	0.28	0.8 -1.2%	38-41 %

Nga provat e studjuara për vetitë fiziko-mekanike, rezultojnë se këta gëlqerorë kanë karakteristikat e mëposhtme :

- Lageshtia natyrale 0.061%
- Kapaciteti i lageshtisë 0.07%
- Peshë specifike 2.6-2.7 gr/cm³,
- Kompaktesia 99.3%
- Poroziteti 5%
- Rezistenca në shtypje në gjendje natyrale për 18 kampione të analizuar, rezultojnë nga 865-984 kg/cm².

- Pesha volumore, 2.6 gr/cm³.
- Qendrueshmeria ne terheqj e 120 kg/cm²
- Qendrueshmeria ne prerje, 170 kg/ cm²
- Fortesia sipas Protodiakonovit, 9.6 deri 9.8
- Kendi i ferkimit te brendshem ne kampione, $\varphi 52^{\circ}20$
- Kendi i ferkimit te brendshem ne matricen shkembore $\varphi 46^{\circ}$ deri 51°

Materiali i prodhuar prej tyre mund te perdoret si lende e pare ndertimi, çakell, rere e perpunuar, gure themelesh, stabilizant ne shtrimin e rrugeve, gure ndertimi, prodhim gelqere çimento, etj.

Prodhimi i realizuar nga shfrytezimi i ketij vend burimi ne zonen e kerkuar do te kete si destinacion perdorimin e tij ne industrine e ndertimit te zones se Devollit dhe te Korces ne forme te gureve te prodhuar direkt nga karriera dhe te materialit te perpunuar si rere, granil apo çakull. Per kete arsye, ne varesi te tregut te studiuar dhe te pritshem, subjekti parashikon nje prodhim vjetor maksimal 20 000 m³/vit.

Regjimi i punes

Per realizimin e prodhimit te parashikuar karriera do te punoje rreth 200-240 dite ne vit, 20-22 dite ne muaj me nje nderese ne dite.

Per vitin e pare te aktivitetit te saj karriera do te punoje me nje intensitet me te larte per realizimin e rrugeve te hapjes ne pjesen e sipërme dhe te poshteme te saj.

Grafiku i zbulimit dhe prodhimit

Ne vitin e pare parashikohet te realizohet nje prodhim prej 60 000 m³/vit. Vellimi ditor, per vitin e pare do te jete 250 m³/dite, ndersa per vitet e tjera 800-850 m³/dite.

Sistemi i shfrytezimit treguesit tekniko-ekonomike te tyre.

Ne zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit jane mare parasysh faktoret e meposhtem :

- Menyra e ngarkimit dhe transportit te steril it
- Menyra e kryerjes se punimeve te zbulimit
- Menyra e ngarkimit dhe transportit te gurit gelqeror ne brendesi te karrieres dhe jashte saj
Ngarkimi i gurit gelqeror ne sheshet e karrieres parashikohet te kryhet me eskavator me kove 1,0 m³.

Transporti i sterilite nga shkallet e karrieres deri ne vend depozitim, ne nje distance mesatare rreth 400 m do te behet me kamione .

Bazuar ne sa me siper sistemi i shfrytezimit qe parashikohet te perdoret eshte i thjeshte me transport te sterilite brenda karrieres ne distance deri 600 m.

Elementet e sistemit te shfrytezimit qe parashikohet te perdoret ne kete objekt jane

- Lartesia e shkalles se karrieres eshte 10m
- Gjeresia e sheshit te punes nga 8-12 m ne 20-40m

- Kendi i skarpates se shkalle s 70-73⁰
- Gjeresia e shesheve perfundimtare te shkalleve 3 m
- Kapaciteti ditor 250-850 m³
- Bartja dhe transporti i mekanizuar;
- Rezimi i i gurit gelqeror me perdorimin e lende s plasese
- Rendimenti per dite pune efektive te punonjesve direkte 25-45 m³/dp
- Rendimenti per dite pune efektive te punonjesve gjithsej 10-25 m³/dp

Rradha dhe drejtimi i shfrytezimit

Ne vitin e pare, pas kryerjes se skarifikimeve, gerimeve dhe sistemimeve te ndryshme, po ne parashikohet te filloje dhe prodhimi i gurit gelqeror ne sasine e parashikuar prej 60000 m³.

Pas hapjes dhe pergatitjes se shkalleve + 1 090m dhe + 1160 m prodhimi do te filloje dhe do te vazhdoje ne menyre suksesive pothuajse ne qender te objekti dhe do te shtrihet gjate gjithe gjatesise se tij ne te dy krahet.

Drejtimi i shfrytezimit. Drejtimi shfrytezimit te objektit do te jete pergjithesisht nga qendra per ne kufi duke u zhvendosur ne te dy drejtimet Lindje dhe Perendim deri ne kufijte ekstrem te zones se shfrytezimit.

Orjentimi i pergjithshem i shkalleve do te jete sipas izohipseve te terenit (shih planimetrine e karriere s ne gjendjen perfundimtare):

Percaktimi i numrit te mjeteve te shpimit

Shpimi i birave do te behet me sonde me zinxhira me diameter shpimi deri 100 m/m dhe me aftesi shpuse 150 ml/nderrese, Sonda do te jete pneumatike dhe do te shoqerohet nga nje moto kompresor i tipit atlas Copcome kapacitet 18.2m³/minute dhe presion 8 bar. Prodhimtaria mesatare ne nje shperthim per nje pus me diameter 100 m/m dhe thellesi 11 ml do te jete rreth 220m³.

Per ngarkim gurit gelqeror ne sheshet e karrieres do te perdoren eskavatore te fuqishem me kapacitet kove 1 m ,i shoqeruar me fadrome me kove me kapacitet 0.75-1 m³

Fadroma do te beje zhvendosjen e gurit gelqeror ne sheshe ne nje distance maksimale 80 m si dhe per pjesen e poshteme transportin e tij drejt bunkerit te pranimit te impiantit.

Per transportin e steril it dhe mineralit parashikohet te perdoren automjete 40 toneshe. Perfundimisht, per transportin e sterilite dhe mineralit do te nevojitet 1 kamion.

Zgjedhja e buldozereve dhe numri i tyre

Per zbankimin dhe sistemimin e nje pjese te streileve ne distancen maksimale te prashikuar ne projekt eshte i mjaftueshem perdorimi i nje buldozieri.

Theksojme se treguesit teknike te ket yre makinerive te ngarkimit dhe transportit jane te tilla qe mund te perballojne kapacitet me te medha prodhimi, por ato mund te perdoren dhe per kryerjen e punimeve te tjera qe subjekti kryen j asht e atij te shfryezimit te mineralit.

5. Permbledhje jo-teknike te Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis ne nivel kombetare ose nderkombetar kur kerkohet procedura e VNM-es.

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”, referuar dhe aktivitetit dhe natyres se veprimtarise se propozuar si dhe pershkrimtit:

Shtojca II: 2 – Industria nxjerrese

2.1. Gurore, miniera siperfaqesore dhe njerrje e torfes (projekte qe nuk jane perfshire ne shtojcen I)

Por, theksojme qe ky eshte nje instalim ekzistuese dhe qe eshte ne funksionim, pra nuk eshte nje instalim i ri. Ne keto kushte, nuk eshte nen juridiksionin e ligjit per VNM.

Siç edhe dime Lejet e mjedisit lidhen së pari me operimin e instalimeve dhe kanë fokusim më të ngushtë – kryesisht ndotja mjedisore – shkarkimet në ajër, shkarkimet, mbetjet etj. Qëllimi i aplikimit të lejes së mjedisit është t'i sigurojë autoritetit kompetent informacion duke demonstruar që instalimi i propozuar do të operojë për të reduktuar ndotjen duke përdorur TMD. Leja e mjedisit jepet vetëm kur është rasti. Te lejet e mjedisit, ndikimet mjedisore nuk janë të balancuara përkundrejt kostove të tjera dhe përfitimeve në vendim marrjen.

Ne konkluzion, veprimtaria e propozuar e guorores nuk kerkon hartimin e Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, mbeshtetur edhe ne shkresen Nr.226/1, date 06.02.2017 te Agjencise Kombetare te Mjedisit (AKM)

6. Konsultime nderkufitare kur kerkohen sipas legjislacionit ne fuqi

Projekti i propozuar nuk zhvillohet ne zone nderkufitare, ndaj dhe nuk i nenshtrohet konsultimeve nderkufitare.

7. Autoriteti vendimmarres per dhenien e aktit te miratimit te lejes se mjedisit, procedurat dhe afatet qe do te ndiqen

Referuar percaktimit te bere ne piken 1 te kesaj kerkese dhe mbeshtetur ne Ligjin Nr.10488, date 14.07.2011 “Per lejet e Mjedisit”, percaktuam llojin e lejes mjedisore: Leje Mjedisore tipi B.

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.10488, date 14.07.2011, nenin 4 – Sistemi i lejeve te mjedisit, pika 1-b, percakton: leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji;

pika 2, percakton:

Autoritetet kompetente për lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C janë si më poshtë:

a) **Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)** është autoriteti ku bëhet kërkesa dhe ku lëshohet leja e mjedisit të tipit A, B dhe C;

- b) Ministri është autoriteti që firmos aktin e miratimit të lejeve të mjedisit të tipit A dhe B, pasi ato të shqyrtohen dhe përgatiten nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- c) Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti që verifikon saktësinë e informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi të tipit A dhe B dhe që i jep mendimin e argumentuar ministrit për dhënien ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara, të shkruara, të cilat lëshohen nga QKB-ja;

Ne lidhje me procedurat dhe afatet për marrjen e lejes së tipit “A”, duhet t’i referohemi VKM Nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C”.

VKM Nr.419, datë 25.06.2014, Kreu III, – Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe percaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit B percakton procedurën si më poshtë:

KREU II

1. Kërkuesi që aplikon pranë QKB-së për pajisjen me leje mjedisi të tipit A duhet të dorëzojë këto dokumente:

- a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit A, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit A, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”;
- c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;
- ç) Kopjen e vendimit të AKM-së për VNM-në paraprake ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas percaktimit në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.
- d) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet.
- dh) Relacionin rreth dëgjësës me publikun, sipas percaktimit në pikën 13 të kreut VI të këtij vendimi.

2. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit për leje mjedisi të tipit B nga QKLja, dërgon një kopje të aplikimit në institucionet e mëposhtme, të cilët japin mendimin e tyre, me shkrim dhe në formë elektronike, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune:

- a) Drejtoritë teknike në Ministrinë e Mjedisit, sipas specifikave të instalimit;
- b) Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP);
- c) Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM).

3. Nëse institucionet e përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, nuk shprehën brenda afatit, AKM-ja vijon me procedurën.

4. AKM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, pas verifikimit për saktësinë e dokumentacionit të aplikimit për lejen e mjedisit të tipit B dhe mbledhjes së mendimeve nga publiku e institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij kreu, harton aktin e miratimit/refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të tipit B, të shoqëruar me argumentet përkatëse, dhe e dërgon tek ministri.

5. Ministri, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes, firmos aktin e miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit B ose ia kthen praktikën AKM-së për shtesa apo ndryshime të këtij akti, të shoqëruar me argumentet përkatëse.

6. AKM-ja, brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim, publikon vendimin e miratimit ose të refuzimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve për leje mjedisi të tipit A.

Referuar pikës 1, dh) të këtij kreu – për të bërë të mundur aplikimin për leje mjedisi në QKB, kërkohet të hartohet relacioni për dëgjuesen me publikun sipas percaktimeve të bërë në pikën 13, Kreun VI i këtij vendimi:

13. Kërkuesi, kur aplikon për leje mjedisi të tipi A dhe të tipit B, harton një relacion rreth dëgjësës me publikun dhe palët e interesuara dhe e dorëzon në QKB.

Kreu VI i këtij vendimi, përcakton procedurat e indormimit dhe pjesmarres se publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B, si me poshte vijon:

1. Kërkuesi, përpara aplikimit në QKB, dërgon në AKM, në njësinë e qeverisjes vendore (NJQV) dhe Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM) ku do të ketë vendndodhjen instalimi një njoftim, me shkrim dhe në formë elektronike (CD, DVD), për aplikimin që do të kryejë për t'u pajisur me leje mjedisore të tipit A ose B, në të paktën 20 kopje elektronike për secilin institucion.
2. Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:
 - a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B".
 - b) Të dhënat e ekstraktit të QKB-së;
 - c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;
 - ç) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
 - d) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
 - dh) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së;
 - e) Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
 - ë) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
 - f) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.
3. AKM-ja publikon, në faqen e saj të internetit, njoftimin sipas pikës 2 të këtij kreu, për të paktën 20 (njëzet) ditë kalendarike, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.
4. Pas publikimit të njoftimit në faqen e internetit të AKM-së, kërkuesi publikon në, të paktën, një gazetë të zonës ku do të ushtrohet veprimtaria dhe në një gazetë kombëtare njoftimin për aplikimin, duke iu referuar për informacion më të hollësishëm faqes së internetit të AKM-së. Njoftimi publikohet në, të paktën, dy numra të njëpasnjëshëm të secilës gazetë.
5. Njoftimi në gazetë duhet të përmbajë, të paktën:
 - a) llojin e instalimit/veprimtarisë;
 - b) emrin e personit fizik/juridik;
 - c) adresën e vendndodhjes së instalimit;
 - ç) adresën e internetit ku është publikuar njoftimi dhe adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.
6. NJQV-ja (bashkia apo komuna), në territorin e së cilës do të jetë vendndodhja e instalimit, pasi merr njoftimin sipas pikës 2, të këtij kreu, e publikon në një vend të dukshëm në mjediset e saj për të paktën 20 (njëzet) ditë.
7. Publiku ka të drejtë të konsultojë në mjediset e NJQV/AKM/ARM dhe të kërkojë një kopje të njoftimit, sipas pikës 2, të këtij kreu, nga NJQV/AKM/ARM, pa pagesë.
8. Publiku mund të bëjë komente, me shkrim ose në mënyrë elektronike, mbi njoftimin për leje mjedisi të tipit A në adresën e AKM-së brenda afatit 20-ditor të publikimit.
9. Në përfundim të afatit 20-ditor, kërkuesi, në bashkëpunim me AKM-në dhe NJQV-në, brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve organizon një dëgjësë me publikun dhe palët e interesuara, përfshirë OJF-të.
10. Njoftimi për dëgjësën me publikun shpallet gjatë 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve:
 - a) në radio ose TV dhe gazetën vendore;
 - b) në faqen e internetit të AKM-së dhe NJQV-së;
 - c) në tabelën e njoftimeve, në një vend të dukshëm në mjediset e NJQV-së dhe ARM-së së qarkut përkatës.
11. Njoftimi duhet të shoqërohet me:
 - a) llojin e instalimit/veprimtarisë;
 - b) emrin e personit fizik/juridik;
 - c) adresën e vendndodhjes së instalimit;

- ç) vendin ku gjendet kopja e njoftimit në NJQV-në dhe adresën elektronike të AKM-së ku është publikuar njoftimi.
dh) përcaktimin e vendit, të datës dhe orës së organizimit të dëgjësës me publikun.
12. Procesverbali i dëgjësës mbahet nga kërkuesi dhe nënshkruhet nga pjesëmarrësit në dëgjësë. Kopje të procesverbalit u vihen në dispozicion publikut, palëve pjesëmarrës në dëgjësë, NJQV-së dhe AKM-së.
 13. Kërkuesi, kur aplikon për leje mjedisi të tipi A dhe të tipit B, harton një relacion rreth dëgjësës me publikun dhe palët e interesuara dhe e dorëzon në QKL.
 14. Shpenzimet e organizimit të dëgjësës mbuloohen nga kërkuesi.
 15. AKM-ja, gjatë hartimit të aktit të miratimit të lejes së mjedisit të tipit A dhe B, merr parasysch çdo koment, informacion, analizë apo mendim të paraqitur nga publiku që vlerësohet i vlefshëm dhe argumenton arsyet kur ato nuk janë marrë parasysch.
 16. AKM-ja, kur e gjykon të arsyeshme, delegon ARM-në e qarkut përkatës për të marrë pjesë në dëgjësën me publikun.

Ne kuader te kesaj kerkese te sipercituar kemi filluar kete procedure te informimit dhe konsultimit me publikun per veprimtarine e propozuar te prodhimit te pelletit.

8. Adresen e AKM-es ku publiku mund te dergoje komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo ne forme elektronike, brenda 20 diteve nga data e njoftimit.

Autoriteti shteteror ku mund te dergohen komentet dhe sugjerimet per sa pershkruhet ne kete kerkese per informim dhe konsultim te publikut eshte:

Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM)

Adresa: Rr. "Sami Frasheri", Nr.4, Tirane
Tel & Fax: 04 2 371 237
www.akm.gov.al
e-mail: info@akm.gov.al

Kerkuesi,

Viktor QYLAFI

ADMINISTRATOR